

# Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar:

- a) Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
- b) Kryetarit dhe Anëtarëve të Departamentit të Financës të Partisë Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare

Raporti mbi Auditimin e Raportit Financiar vjetor 2023

## Refuzimi i Opinionit

Ne u angazhuam për të audituar raportin financiar vjetor të **Partisë Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare**, të cilat përfshijnë aktivet dhe detyrimet më 31 Dhjetor 2023, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin që përfundon në atë datë, dhe shënimet shpjeguese të raportit financiar.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportin financiar. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin **Baza për Refuzimin e Opinionit** të raportit tonë, nuk kemi mundur të sigurojmë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të formuar një bazë për një opinion auditimi.

## Baza për Refuzimin e Opinionit

Ne nuk mundëm të siguronim prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme për shkak të arsyeve të mëposhtme:


- Nuk mundëm të vendosim kontakt me menaxhmentin, dhe për rrjedhojë, nuk arritëm të kryenim procedurat e nevojshme të auditimit për të formuar një opinion mbi raportin financiar.

Me cilësinë e Audituesit Ligjor të emëruar me vendim nr. 56 datë 28.6.2024 "Përzgjedhjen e Ekspertëve Kontabël të Licensuar (Auditues Ligjor) për Auditimin e Fondeve të Përfituara dhe të Shpenzuara nga Partitë Politike për Vitin Kalendarik 2023," për realizimin e misionit kemi kryer procedurat e mëposhtme:

Pas nënshkrimit të Kontratës nr. 2230 prot date 27/07/2024 lidhur me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2023, dërguam njoftim Subjektit "Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare", në adresën e përcaktuar në kontratën e auditimit për Subjektin, nëpërmjet shërbimit postar me numër 1060 datë 30/07/2024, ku e vendosim në dijeni Partinë Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare:

- a) Kontratën e shërbimit me nr. 2230 prot date 27/07/2024;
- b) detyrat e audituesit ligjor në këtë angazhim auditimi;
- c) Kërkohet bërja e mundur për përcaktimin e një dite dhe orari kohor për paraqitjen e audituesit ligjor në selinë e Partisë ku do të diskutojmë objektivat dhe planin e auditimit
- d) Afatet ligjore dhe kontraktuale për mbarimin e misionit auditimit
- e) Kërkohen të dërgohen të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës nga departamenti i financës me të cilin do të bashkëpunojmë gjatë procesit të auditimit, duke përfshirë emrin, mbiemrin, adresën e email-it dhe numrin e telefonit.

Në datë 02/08/2024 nga ana e shërbimit postar njoftohemi për mosdorëzim të postës për arsye mos gjetjes së adresës (bashkëngjitur njoftimi dhe zarfi i kthyer).



Më tej, me datë 09/08/2024, kemi njoftuar KQZ nëpërmjet email, ku e vëmë në dijeni se Posta ka kthyer përgjigje se adresa e Subjektit është e pamjaftueshme dhe i kërkojmë nese mund të na vendosin në dispozicion informacione shtese per te kontaktuar Partinë si adresa email ose numra telefoni te Kryetarit ose personit te finances. Nuk kemi arritur të marrim një përgjigje me të dhëna të tjera që mund të ndihmonin kontaktimin me Partinë.

- Si pasojë, nuk mundëm të sigurojmë prova mbi çështje kritike, të tilla si ekzistenca, plotësia dhe vlerësimi i aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve neto më 31 Dhjetor 2023, dhe as nuk mundëm të verifikonim saktësinë e transaksioneve dhe balancave.

Për shkak të këtyre kufizimeve, nuk ishim në gjendje të formonim një opinion.

---

#### Përgjegjësitë e drejtimit në lidhje me raportin financiar

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportit financiar vjetor në përputhje me SKK-të dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit.

---

#### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e raportit financiar vjetor

Përgjegjësia jonë është të kryejmë një auditim të raportit financiar të subjektit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe të lëshojmë një raport auditimi. Megjithatë, për shkak të çështjeve të përshkruara në seksionin **Baza për Refuzimin e Opinionit**, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të formuar një bazë për një opinion auditimi.

Ne jemi të pavarur nga Subjekti në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Auditues Ligjor  
Iris QIRJAQI

04 Shtator 2024  
Tiranë, Shqipëri



**KEI Auditing & Consulting**

Mobile: +355 689055228

Email: [iris.qirjaqi@keiauditing.com](mailto:iris.qirjaqi@keiauditing.com)

Rruga Skender Luarasi, 1 floor, Tirana, Albania

[www.keiauditing.com](http://www.keiauditing.com)



RR 647 146 945 AA 28

Vula e Zyrës Pranuese të Lajmërimit

LAJMËRIM MARRJE NR .....

Ky lajmërim - marrje do të kthehet në adresën time si më poshtë:

Z. .... P.R. S. P. R. A. F. S. ....  
Drejtuesi  
Shërbimi Gjenerale Sen Jozefi Metin  
Nol. 3 - H. 6  
Tiranë

0689055228

Plotësohet nga dërguesi i cili duhet të tregojë drejtimin e tij të plotë për kthimin e këtij lajmërimi

Mod P6

Mod. E-10

KTHEHET

IPANORUR

LARGUAR

ADRESE PAMIAFTUESHME

KA NDRYSHUAR ADRESE

OBJEKT I PA KERKUAR

REFUZUAR

ADRESE E PASAKTE

DATA E KTHIMIT



RR 645 670 925 AA



M. Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike  
Shqipëri

Adri Ruzja Islam Alla, Nr. 20  
Tiranë, Shqipëri

Nr: 1060

DEFTESA 30/07/2024 19:14:34

PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE

Objekti Letra Leter  
KOD-BAR RR645670925AA

Dërguesi IRIS QIRJAZI  
Marresi PARTIA BËSELIDHJA  
KOMBËTARE  
DEMOKRATIKE  
SHQIPTARE

Vend Mbërritja TIRANA  
Pesha 30 gr  
LM RR647146945AA

Sherbime te vecanta	
LM ne postim	50
Tarifa Shtese	50
Tarifa Postare	80
Tarifa Totale	130
Nenshkrimi:	etleva.alika